



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEČAN ZVEČAN MUNICIPALITY	
Nr. lista Org. Org. Jesh. Org. Unif.	CO
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr.	B-1-2/26
Nr. i faqeve Br. strarica No. pages	5
Data Datum Date	07. 04. 2026



Opština Zvečan
Komuna e Zveçanit
Municipality of Zvečan

ЗАПИСНИК

са 1. (прве) ванредне седнице Скупштине општине Звечан у 2026. години

Прва ванредна седница Скупштине општине Звечан у 2026. години одржана је дана 07.04.2026. године са почетком у 11:00 часова у скупштинској сали општине Звечан.

Седницом је председавао др Срђан Милосављевић, председавајући Скупштине општине Звечан. Председавајући је у уводном обраћању поздравио градоначелника господина Драгишу Миловића, заменика градоначелника Ивана Тодосијевића представнике Министарства администрације и локалне самоуправе (МАЈС), представнике медија, међународних организација, директоре одељења, запослене у општинској администрацији и госте.

Након позива председавајућег, административни службеник Скупштине општине, господин Милош Недељковић, известио је о присуству одборника. Констатовано је да седници присуствује 12 од 15 одборника колико броји Скупштина, чиме је на основу члана 46. Закона о локалној самоуправи бр. 03/L-040, утврђено постојање кворума за рад и пуноважно одлучивање.

Седници су присуствовали следећи одборници:

1. Предраг Радовановић
2. Јасминка Млађовић
3. Часлав Софронијевић
4. Марија Јовановић
5. Срђан Милосављевић
6. Радомир Вучовић
7. Милош Радосављевић
8. Бранислав Милић

9. Ивана Ђокић
10. Јелена Никић
11. Радосав Радомировић
12. Зоран Обреновић

Седници нису присуствовали следећи одборници:

1. Иван Васић
2. Лука Јовановић
3. Илир Пеци

С обзиром да је материјал за седницу прослеђен свим одборницима путем електронске поште, председавајући је, у складу са законом, прочитао дневни ред који је садржао само једну тачку, и то:

Дневни ред:

1. Формирање Одбора за заједнице.

Председавајући је у свом излагању констатовао да су одборници благовремено примили позив за седницу, као и предложени дневни ред. Утврђено је да је реч о првој ванредној седници у текућој години, сазваној у складу са одредбама члана 43. став 1. и члана 44. став 1, 2. и 6. Закона о локалној самоуправи.

Председавајући је образложио да је основни разлог за сазивање ове седнице поступање по захтеву Министарства администрације и локалне самоуправе у вези са формирањем Одбора за заједнице у Скупштини општине Звечан. Подсетио је присутне да је на првој редовној седници у 2026. години, одржаној 30. јануара 2026. године, донета одлука о формирању овог одбора. Даље је наведено да је Министарство, након разматрања достављене одлуке, заузело став да она није у потпуности усклађена са важећим законодавством. У образложењу Министарства истакнуто је да у саставу Одбора, на основу члана 53.1 није обезбеђена одговарајућа заступљеност чланова Скупштине који припадају невећинским заједницама. Председавајући је нагласио да оваква формулација није изричито

прописана законом, већ да закон предвиђа учешће чланова Скупштине и представника заједница.

У наставку је појашњено да је Министарство своје мишљење засновало на тумачењу члана 53. став 1. Закона о локалној самоуправи. Истакнуто је да на Косову постоје три службене језичке верзије закона, и то српска, албанска и енглеска верзија које се у овом члану међусобно разликују.

У даљем излагању председавајући се осврнуо и на примедбе које се односе на родну равноправност. Наведено је да су у конкретном случају у Одбору заступљене три жене и два мушкарца, што је најближе могућем односу равномерне родне заступљености, имајући у виду непаран број чланова. Такође је размотрена примедба Министарства у вези са применом члана 8. став 2. Административног упутства број 05/2020, које регулише поступак оснивања, састав и надлежности сталних одбора. Истакнуто је да и ово упутство предвиђа да свака заједница мора имати најмање једног представника, да невећинске заједнице треба да чине већину, као и да се обезбеди родна равноправност. Констатовано је да су сви ови услови били испуњени претходном одлуком.

Председавајући је затим информисао присутне о току комуникације са Министарством. Наведено је да је Одлука првобитно достављена Министарству 4. фебруара, али да, услед техничких проблема са сервером, није примљена. Поновно слање извршено је 12. фебруара, а у Министарству је акт заведен 13. фебруара. Одговор Министарства достављен је 5. марта. Указано је да Закон о локалној самоуправи, у члану 81. став 4, прописује рок од 15 дана за давање мишљења о законитости акта, те је констатовано да је у конкретном случају тај рок прекорачен. Са друге стране, Министарство се позвало на уредбу која предвиђа рок од 30 дана, што је оцењено као неусклађено са законом. Истакнуто је да је општина дужна да поступи по налогу Министарства у року од 30 дана од пријема оцене законитости, због чега је и сазвана ова седница.

Председавајући је додатно навео да је 26. марта 2026. године Министарству упућен допис ради појашњења, али да до дана одржавања седнице није стигао одговор. На крају је образложено да је рок за поступање истекао 4. априла, али како је тај дан пао у суботу, а недеља и понедељак били нерадни дани, због католичког Ускрса, први наредни радни дан био је дан одржавања седнице. Сходно томе, седница је благовремено заказана у складу са законом.

Након уводног излагања, председавајући је предложени дневни ред ставио на гласање и позвао одборнике да се изјасне о његовом усвајању. **По спроведеном гласању утврђено је да није било гласова против нити уздржаних, те је председавајући констатовао да је дневни ред усвојен једногласно.**

Потом је указано да се, у складу са важећим прописима који уређују рад ванредних седница, дневни ред не може накнадно допуњавати, већ се расправа и одлучивање могу водити искључиво по тачки која је претходно утврђена и усвојена.

Тачка 1.

Формирање Одбора за заједнице

У циљу поштовања законских одредби и поступања по мишљењу надлежног Министарства, председавајући је предложио нови састав Одбора за заједнице. Том приликом је истакао да је неопходно обезбедити испуњење више кључних услова: да се обезбеди проста већина чланова из реда одборника Скупштине, да представници невећинских заједница чине већину у укупном саставу Одбора, да Одбор има 5 чланова у складу са чланом 31. став 2. статута општине Звечан, као и да се обезбеди што равномернија родна заступљеност у складу са важећим прописима. Такође је наглашено да предложени састав мора бити у складу са Законом о локалној самоуправи, посебно чланом 53. став 1. као и са Административним упутством које регулише поступак формирања и надлежности сталних одбора, конкретно чланом 8. тог акта. Председавајући је истакао да је, приликом формулисања предлога, извршена детаљна анализа свих релевантних правних прописа, као и да су обављене консултације са представницима међународних организација, укључујући и представнике ОЕБС-а, како би се дошло до решења које је у највећој могућој мери усклађено са законским оквиром и праксом.

На основу свега наведеног, предложен је следећи састав Одбора за заједнице:

1. Дијана Радовановић – чланица (жена, представница црногорске заједнице),
2. Инес Аљовић – чланица (жена, представница бошњачке заједнице),
3. Илир Пеци – члан (мушкарац, одборник Скупштине и представник албанске заједнице),
4. Предраг Радовановић – члан (мушкарац, одборник Скупштине),
5. Радомир Вучовић – члан (мушкарац, одборник Скупштине).

Након исцрпног образложења, председавајући је ставио на гласање предлог одлуке о формирању Одбора за заједнице, уз напомену да се усвајањем ове одлуке претходно донета одлука ставља ван снаге. **Након спроведеног гласања, председавајући је констатовао да нема гласова против, нити уздржаних, те да је Одлука о формирању Одбора за заједнице једногласно усвојена.**


На основу резултата гласања утврђено је да је Скупштина општине Звечан, на својој 1. (првој) ванредној седници у 2026. години, донела Одлуку о формирању Одбора за заједнице у предложеном саставу.

С обзиром на то да је ово била једина тачка дневног реда, председавајући је констатовао да је дневни ред у потпуности исцрпљен. На крају је утврђено да је прва ванредна седница Скупштине општине Звечан у 2026. години завршена у 11:33 сати.

У Звечану,

Дана: 07.04.2026.

Записничар:



Милош Недељковић, мастер правник,
административни асистент Скупштине

Председавајући Скупштине
општине Звечан



Др. Срђан Милосављевић



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republika e Kosovës

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E ZVEÇANIT OPŠTINA ZVEÇAN ZVEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. Prot. Org. Jed. Org. Unit. C.O	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. Nr. B-1-2/26
Nr. i faqev. Br. stranic. No. pages 5	Data Datum. DATE 07. 04. 2026



Komuna e Zveçanit
Komuna e Zveçanit
Komuna e Zveçanit

PROCESVERBAL

nga mbledhja e 1-rë (e parë) e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026

Mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026 u mbajt më 07.04.2026, me fillim në ora 11:00, në sallën e kuvendit të Komunës së Zveçanit.

Me mbledhjen kryesoi dr. Srđan Milosavljević, kryesues i Kuvendit të Komunës së Zveçanit. Në fjalën hyrëse, kryesuesi përshëndeti kryetarin e komunës, z. Dragiša Milović, nënkryetarin e komunës Ivan Todosijević, përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përfaqësuesit e mediave, organizatave ndërkombëtare, drejtorët e drejtorive, të punësuarit në administratën komunale dhe mysafirët.

Pas thirrjes së kryesuesit, zyrtari administrativ i Kuvendit të Komunës, z. Miloš Nedeljković, raportoi për praninë e anëtarëve të Kuvendit. U konstatua se në mbledhje janë të pranishëm 12 nga 15 anëtarë sa numëron Kuvendi, me ç'rast, në bazë të nenit 46 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, u konstatua ekzistimi i kuorumit për punë dhe vendimmarrje të vlefshme.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Kuvendit si vijon:

1. Predrag Radovanović
2. Jasminka Mladović
3. Časlav Sofronijević
4. Marija Jovanović
5. Srđan Milosavljević
6. Radomir Vučović
7. Miloš Radosavljević
8. Branislav Milić
9. Ivana Đokić

10. Jelena Nikić
11. Radosav Radiomirović
12. Zoran Obrenović

Në mbledhje nuk morën pjesë anëtarët e Kuvendit si vijon:

1. Ivan Vasić
2. Luka Jovanović
3. Ilir Peci

Duke pasur parasysh se materiali për mbledhje u është përcjellë të gjithë anëtarëve të Kuvendit përmes postës elektronike, kryesuesi, në përputhje me ligjin, e lexoi rendin e ditës, i cili përmbante vetëm një pikë, edhe atë:

Rendi i ditës:

1. Formimi i Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi në fjalën e tij konstatoi se anëtarët e Kuvendit e kanë pranuar me kohë ftesën për mbledhje, si dhe rendin e propozuar të ditës. U konstatua se bëhet fjalë për mbledhjen e parë të jashtëzakonshme në vitin rrjedhës, të thirrur në përputhje me dispozitat e nenit 43 paragrafi 1 dhe nenit 44 paragrafët 1, 2 dhe 6 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kryesuesi sqaroi se arsyeja themelore për thirrjen e kësaj mbledhjeje është veprimi sipas kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me formimin e Komitetit për Komunitete në Kuvendin e Komunës së Zveçanit. Ai i rikujtoi të pranishmit se në mbledhjen e parë të rregullt në vitin 2026, të mbajtur më 30 janar 2026, ishte miratuar vendimi për formimin e këtij komiteti. Më tej u theksua se Ministria, pas shqyrtimit të vendimit të dërguar, ka mbajtur qëndrimin se ai nuk është plotësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në arsyetimin e Ministrisë u theksua se, në përbërjen e Komitetit, në bazë të nenit 53.1, nuk është siguruar përfaqësimi i duhur i anëtarëve të Kuvendit që u përkasin komuniteteve joshumicë. Kryesuesi theksoi se një formulim i tillë nuk është i përcaktuar shprehimisht me ligj, por se ligji parasheh pjesëmarrjen e anëtarëve të Kuvendit dhe të përfaqësuesve të komuniteteve.

Më tej u sqarua se Ministria e ka bazuar mendimin e saj në interpretimin e nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. U theksua se në Kosovë ekzistojnë tri versione zyrtare gjuhësore të ligjit, përkatësisht versioni në gjuhën serbe, shqiptare dhe angleze, të cilat në këtë nen dallojnë ndërmjet vete.

Në vazhdim të ekspozesë së tij, kryesuesi u ndal edhe te vërejtjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. U theksua se, në rastin konkret, në Komitet janë të përfaqësuara tri gra dhe dy burra, që është raporti më i afërt i mundshëm me përfaqësimin e barabartë gjinor, duke pasur parasysh numrin tek të anëtarëve. Po ashtu, u shqyrtua edhe vërejtja e Ministrisë lidhur me zbatimin e nenit 8 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2020, i cili rregullon procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme. U theksua se edhe ky udhëzim parasheh që secili komunitet duhet të ketë së paku një përfaqësues, që komunitetet joshumicë duhet ta përbëjnë shumicën, si dhe që të sigurohet barazia gjinore. U konstatua se të gjitha këto kushte kanë qenë të përmbushura me vendimin e mëparshëm.

Kryesuesi më pas i informoi të pranishmit për rrjedhën e komunikimit me Ministrinë. U theksua se Vendimi fillimisht i ishte dërguar Ministrisë më 4 shkurt, por se, për shkak të problemeve teknike me serverin, nuk ishte pranuar. Ridërgimi është bërë më 12 shkurt, ndërsa në Ministri akti është protokolluar më 13 shkurt. Përgjigjja e Ministrisë është dorëzuar më 5 mars. U theksua se Ligji për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 81 paragrafi 4, përcakton afatin prej 15 ditësh për dhënien e mendimit lidhur me ligjshmërinë e aktit, andaj u konstatua se në rastin konkret ky afat është tejkaluar. Në anën tjetër, Ministria iu referua një rregulloreje që parasheh afat prej 30 ditësh, gjë që u vlerësua si jo në përputhje me ligjin. U theksua se komuna është e obliguar të veprojë sipas urdhrat të Ministrisë brenda afatit prej 30 ditësh nga pranimi i vlerësimit të ligjshmërisë, për ç'arsye edhe është thirrur kjo mbledhje.

Kryesuesi shtoi gjithashtu se më 26 mars 2026 Ministrisë i është dërguar një shkresë për sqarim, por se deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes nuk ka arritur përgjigjja. Në fund u sqarua se afati për veprim kishte skaduar më 4 prill, por meqenëse ajo ditë ka rënë të shtunën, ndërsa e diela dhe e hëna kanë qenë ditë jopune, për shkak të Pashkëve katolike, dita e parë e ardhshme e punës ishte dita e mbajtjes së mbledhjes. Rrjedhimisht, mbledhja është caktuar me kohë dhe në përputhje me ligjin.

Pas fjalës hyrëse, kryesuesi e hodhi në votim rendin e propozuar të ditës dhe i ftoi anëtarët e Kuvendit të deklarohen për miratimin e tij. **Pas votimit të zhvilluar u konstatua se nuk pati vota kundër e as abstenime, andaj kryesuesi konstatoi se rendi i ditës u miratua njëzëri.**

Më pas u theksua se, në përputhje me dispozitat në fuqi që rregullojnë punën e mbledhjeve të jashtëzakonshme, rendi i ditës nuk mund të plotësohet më vonë, por diskutimi dhe vendimmarrja mund të zhvillohen vetëm për pikën e cila paraprakisht është përcaktuar dhe miratuar.

Pika 1.

Formimi i Komitetit për Komunitete

Me qëllim të respektimit të dispozitave ligjore dhe veprimit sipas mendimit të Ministrisë kompetente, kryesuesi propozoi përbërjen e re të Komitetit për Komunitete. Me këtë rast, ai theksoi se është e domosdoshme të sigurohet përmbushja e disa kushteve kyçe: që të sigurohet shumica e thjeshtë e anëtarëve nga radhët e anëtarëve të Kuvendit, që përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë ta përbëjnë shumicën në përbërjen e përgjithshme të Komitetit, që Komiteti të ketë 5 anëtarë në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Zveçanit, si dhe të sigurohet përfaqësim sa më i barabartë gjinor në përputhje me dispozitat në fuqi. Po ashtu, u theksua se përbërja e propozuar duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në veçanti me nenin 53 paragrafi 1, si dhe me Udhëzimin Administrativ që rregullon procedurën e formimit dhe kompetencat e komiteteve të përhershme, konkretisht me nenin 8 të atij akti. Kryesuesi theksoi se, me rastin e formulimit të propozimit, është bërë analizë e hollësishme e të gjitha dispozitave relevante ligjore, si dhe janë zhvilluar konsultime me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe përfaqësues të OSBE-së, me qëllim që të arrihet një zgjidhje e cila, në masën më të madhe të mundshme, është në përputhje me kornizën ligjore dhe praktikën.

Bazuar në të gjitha sa u tha më sipër, u propozua kjo përbërje e Komitetit për Komunitete:

1. Dijana Radovanović – anëtare (grua, përfaqësuese e komunitetit malazez),
2. Ines Aljović – anëtare (grua, përfaqësuese e komunitetit boshnjak),
3. Ilir Peci – anëtar (burrë, anëtar i Kuvendit dhe përfaqësues i komunitetit shqiptar),
4. Predrag Radovanović – anëtar (burrë, anëtar i Kuvendit),
5. Radomir Vučović – anëtar (burrë, anëtar i Kuvendit).

Pas arsyetimit të hollësishëm, kryesuesi e hodhi në votim propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete, me vërejtjen se me miratimin e këtij vendimi vendimi i miratuar më parë shfuqizohet. **Pas votimit të zhvilluar, kryesuesi konstatoi se nuk ka vota kundër, as abstenime, dhe se Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete u miratua njëzëri.**

Në bazë të rezultateve të votimit u konstatua se Kuvendi i Komunës së Zveçanit, në mbledhjen e tij të 1-rë (të parë) të jashtëzakonshme në vitin 2026, e ka miratuar Vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete në përbërjen e propozuar.

Meqenëse kjo ishte pika e vetme e rendit të ditës, kryesuesi konstatoi se rendi i ditës është shteruar plotësisht. Në fund u konstatua se mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Zveçanit në vitin 2026 përfundoi në ora 11:33.

Në Zveçan,

Më: 07.04.2026.

Procesmbajtësi:



Miloš Nedeljković, mastër i drejtësisë,
asistent administrativ i Kuvendit

**Kryesuesi i Kuvendit të
Komunës së Zveçanit**



Dr. Srđan Milosavljević